

THE COLLEGE BOARD

Digital SAT Test Directions Translated into ALBANIAN for Students

Spring 2019 School Day Testing Only

Notes to the Proctor

This document should be printed and distributed once students are seated.

Students may use this document to read translations of the directions that are read aloud or included in the Secure Browser.

Students may keep this document open and on their desk during the entire testing period.

Students may **not** be given additional time, unless approved by the College Board as a separate accommodation.

Collect this document from each student at the end of testing and securely destroy it.

Pasqyra e lëndës

Notes to the Proctor.....	1
1 Shënime për studentin	3
2 Teksti i shkruar i provimit standard dixhital SAT	4
2.1 Para se të fillojë provimi.....	4
2.2 Udhëzime paraprake	6
2.3 Pjesa 1: Test i leximit	9
2.3.1 Pjesa 1 Udhëzimet e provimit	10
2.3.2 Gjatë pushimit.....	11
2.4 Pjesa 2: Testi i shkrimit dhe gjuhës.....	11
2.4.1 Pjesa 2 Udhëzimet e provimit	12
2.4.2 Gjatë provimit.....	13
2.5 Pjesa 3: Testi i matematikës - Pa makinë llogaritëse	13
2.5.1 Pjesa 3 Udhëzimet e provimit	15
2.5.2 Gjatë provimit.....	17
2.5.3 Gjatë pushimit.....	17
2.6 Pjesa 4: Testi i matematikës - Makina llogaritëse	17
2.6.1 Pjesa 4 Udhëzimet e provimit	19
2.6.2 Gjatë provimit.....	21
2.6.3 Gjatë pushimit.....	21
2.7 Eseja SAT	21
2.7.1 Udhëzimet për testin e esesë SAT	23
2.7.2 Gjatë provimit.....	23
3 Pas provimit	24
3.1 Para se të largohen studentët.....	24

1 Shënime për studentin

- Më poshtë është një përkthim i udhëzimeve që kontrollori do t'i lexojë me zë, si edhe udhëzime që gjenden në shfletuesin e sigurt të bordit të kolegjit. Ndiqni ndërsa kontrollori ju lexon me zë udhëzimet në anglisht. Këto udhëzime të përkthyer mund të mos përputhen fjalë për fjalë me atë që do të lexojë kontrollori; sidoqoftë, informacionet në thelb janë të njëjta. Nëse keni pyetje për atë që po lexon kontrollori, ju lutem ngrini dorën.
- Kontrollori mund t'i kapërcejë disa udhëzime që nuk zbatohen në situatën e provimit tuaj.
- Mund ta mbani këtë dokument mbi bankë për gjithë kohën e provimit, por duhet t'ia ktheni kontrollorit pas provimit.
- NUK lejohet ta përdorni këtë dokument për letër shënimesh.
- Në momente të ndryshme, kontrollori do të lajmërojë kohën e mbetur për pjesën e provimit, si edhe pushimet kur është e përshtatshme. Nëse po bëni provimin me një mjet të miratuar, këto lajmërime mund të ndryshojnë nga oraret dhe pushimet e renditura në këtë dokument të përkthyer. Ju lutem dëgjoni me kujdes lajmërimet që ju lexohen nga kontrollori.
- Nëse po bëni provim me mjetet e miratuara, kontrollori mund t'ju japë udhëzime të mëtejshme në anglisht.
- Në këtë dokument janë përdorur ikona për të tërhequr vëmendjen tuaj tek informacione të caktuara:



Informacione të rëndësishme



Udhëzimet e thëna me gojë nga kontrollori



Udhëzime që gjenden në librin e provimit

2 Teksti i shkruar i provimit standard dixhital SAT

2.1 Para se të fillojë provimi

Nëse përdorni kufje gjatë provimit, kontrollori do t'ju sinjalizojë për t'ju treguar se ka një lajmërim për të dhënë.

Kur të gjithë të jenë gati, kontrollori do të thotë:

- Mirë se vini në administrimin e provimit SAT. Kjo është mundësia të tregoni sa të përgatitur jeni për kolegji dhe karrierë.

Para se të fillojmë provimin, do t'ju lexoj disa rregulla dhe udhëzime. Ju lutem dëgjoni me kujdes dhe mbani mend pyetjet derisa t'ju kërkohet.

Të gjithë studentët duhet të kenë mundësi të barabartë për të treguar njohuritë dhe aftësitë e tyre në këtë provim. Për këtë arsye, ka rregulla për t'u siguruar që askush të mos fitojë me padrejtësi. Do t'i eliminojmë dhe anulojmë rezultatet e kujtdo që bën diçka prej të mëposhtmeve:

- Jep ose merr ndihmë të çfarëdo lloji në provim.
- Përdor makinë llogaritëse gjatë pjesës pa makinë llogaritëse (përveç nëse keni një mjet të miratuar).
- Përdor ndonjë mjet ndihmës të paautorizuar, si për shembull telefon, gjatë testimit apo gjatë pushimeve.
- Ndan pyetjet e provimit me cilindo gjatë ose pas provimit.
- Përdor ose përpiqet të përdorë kompjuterin e provimit për ndonjë qëllim tjetër përveçse për provim.
- Del nga dritarja e provimit para mbarimit të këtij administrimi provimi.
- Përpiqet të bëjë provimin në vend të dikujt tjetër.

Gjithashtu mund të përjashtoheni nëse:

- Hani ose pini në sallën e provimit (përveç nëse keni miratim).
- Shkaktoni shqetësim të çfarëdo lloji.
- Nuk ndiqni procedurat e provimit.
- Shkoni te dollapi juaj ose largoheni nga ndërtesa gjatë pushimeve.

Do të keni kohë deri në orën 11:59 të darkës me orën lindore në ditën e katërt të javës nga momenti i mbarimit të provimit për të paraqitur një ankesë për ditën e provimit. Nëse shikoni ndonjë lloj sjelljeje që ju shqetëson, ju lutem njoftoni koordinatoren e provimit që do t'ju shpjegojë si të kontaktoni bordin e kolegjit. A ka dikush ndonjë pyetje për diçka që kam thënë deri tani?

(A) Nëse shkolla ka mbledhur sendet personale të studentëve, kontrollori do të thotë:

- Në këtë moment duhet të keni dorëzuar të gjithë telefonat ose çdo pajisje tjetër elektronike të paautorizuar. Nëse dikush ka ende pajisje elektronike personale të çfarëdo lloji, ju lutem fikini dhe m'i dorëzoni mua tani. Të gjitha do t'ju kthehen në fund të provimit.

(B) Nëse shkolla juaj nuk ka grumbulluar sendet personale të studentëve, kontrollori do të thotë:

- Në këtë moment, nëse keni telefon ose çfarëdo pajisjeje tjetër elektronike të paautorizuar me vete, duhet ta fikni komplet dhe ta lini mënjanë derisa të mbarojë provimi. Çdo pajisje elektronike që nuk është fikur dhe lënë mënjanë mund të konfiskohet dhe përmbajtja e saj mund të kontrollohet si pjesë e një hetimi të hollësishëm.

Nëse keni marrë me vete ushqime ose pije për kohën e pushimit, nxirrini dhe vendosini poshtë bankës tani. Nuk do të lejoheni të futni duart në çanta gjatë pushimeve.

Mbyllini çantat dhe vendosini poshtë bankës derisa të mbarojë provimi.

Pastaj kontrollori do të thotë:

- Tani do të përgatitemi për të filluar provimin.

Ju lutem hiqni çdo gjë nga banka përveç lapsave ose stilolapsave dhe makinës llogaritëse, nëse e keni marrë me vete.

Nëse keni marrë me vete makinë llogaritëse ose bateri rezervë, ju lutem vendosini edhe ato mbi bankë. Nuk lejohet të përdorni të njëjtën makinë llogaritëse me një student tjetër në çfarëdo momenti gjatë provimit ose pushimeve.

Pasi të gjithë të jenë gati, kontrollori do të thotë:

- Faleminderit. Ju lutem rrini ulur me qetësi ndërsa sigurohem një moment që të gjithë të kenë një makinë llogaritëse të aprovuar.

Pasi të gjithë të jenë gati, kontrollori do të thotë:

- Nuk lejohet t'i ndani ose shkëmbeni makinat llogaritëse në asnjë moment. Nëse keni marrë makinë llogaritëse me vete, vëreni makinën llogaritëse dhe bateritë rezervë poshtë bankës tani. Nuk do t'ju duhen deri në një pjesë të mëvonshme.

Nëse nuk keni marrë pjesë tashmë në seancën e administrimit paraprak, kontrollori do t'i japë çdo student një biletë provimi dhe një copë letër për të shkruar. Bileta e provimit do të ketë emrin tuaj të shkruar në të. Kontrollori mund t'ju kërkojë që të tregoni ID-në tuaj për të verifikuar emrin tuaj.

Kontrollori do ta postojë informacionin e mëposhtëm në dërrasë:

- *Today's date (Data e sotme)*
- *Test name (PSAT 8/9) (Emri i provimit: PSAT 8/9)*

Plotësohet më vonë:

- *Session ID (ID-ja e seancës)*
- *Start time (Ora e fillimit)*
- *Stop time (approximate) (Ora e ndalimit, afërsisht)*
- *Break time (Ora e pushimit)*

2.2 Udhëzime paraprake

Kur të gjithë studentët të kenë një biletë provimi dhe të kenë plotësuar pyetëSORIN, kontrollori do të thotë:

- Ju lutem dëgjoni me kujdes këto udhëzime. Kompjuteri duhet të jetë në ekranin e hyrjes në Secure Browser (shfletuesin e sigurt). Nëse nuk shihni ekranin e hyrjes së bordit të kolegjit, ju lutem ngrini dorën.
 - Shkruani **First Name (emrin)** fiks siç është shkruar në biletën e provimit.
 - Shkruani **Registration Number (numrin e regjistrimit)** fiks siç është shkruar në biletën e provimit.
 - Shkruani **Session ID (ID-në e seancës)** fiks siç është në dërrasë.
 - Klikoni **Sign In (Hyr)**.

- Nëse ju del një gabim kur përpiqeni të hyni, ju lutem ngrini dorën dhe unë do t'ju ndihmoj.

Pasi të gjithë studentët të kenë hyrë, kontrollori juaj do të thotë:

- Tani kontrolloni që informacioni të jetë i saktë në faqen "Is This You?" ("A jeni ju?"). Nëse është i saktë, klikoni **Yes (Po)**. Nëse ndonjë informacion nuk është i saktë, ngrini dorën.


Pastaj kontrollori do të thotë:

- Ju lutem rrini ulur qetë dhe prisni aprovimin. Ngrini kokën kur të shihni mesazhin "Waiting for Approval" ("Duke pritur aprovimin").


Kur të gjithë të jenë gati dhe para se atë aprovohen të gjithë studentët, kontrollori do të thotë:

- Për çdo pjesë, do të ndiqni këtë proces për aprovim duke përdorur emrin dhe numrin e regjistrimit nga bileta e provimit dhe një Session ID (ID-në unike të seancës). Nuk do të jeni në gjendje të hyni në një pjesë dhe të filloni provimin derisa unë t'ju jap aprovimin. Para se të aprovoj të gjithë që të fillojnë provimin, mos harroni:
 - Gjatë këtij administrimi provimi, duhet të dëgjoni të gjitha udhëzimet se si të vazhdoni.
 - Mos dilni ose mos u largoni nga seanca e provimit ose mos e mbyllni laptopin derisa provimi të ketë mbaruar. Nëse e bëni këtë, mund të humbisni kohën e provimit ose provimi juaj mund të shënohet si i pavlefshëm.
 - Gjatë provimit, mbajini sytë vetëm në pajisje.
 - Nëse pajisja juaj ka ndonjë defekt gjatë provimit, ngrini dorën.
 - Unë do të silllem nëpër sallë për të kontrolluar ecurinë tuaj.
 - Do të keni pushime gjatë provimit, kur mund të largoheni nga salla për të ngrënë diçka ose për të shkruar në banjë.


Nëse po bëni provimin me funksionin tekst-në-fjalë (text-to-speech), kontrollori do të thotë:

-  Tani duhet të shikoni kontrollin e akustikës së funksionit tekst-në-fjalë. Ju lutem të ndiqni udhëzimet në ekran dhe bëni zgjedhjen në fund të ekranit. Pastaj klikoni **continue (vazhdo)**. Duhet të konfirmoni që parametrat e zërit të jenë vendosur si duhet dhe që funksionojnë çdo herë që hyni në provim. Për të lexuar artikujt e provimit me zë, aktivizoni funksionin tekst-në-fjalë duke përdorur menyën e kontekstit.


Pasi të jenë pranuar të gjithë studentët, kontrollori do të thotë:

-  Jeni pothuajse gati për të filluar. Tani duhet të shihni tre kuti me informacion në ekranin tuaj. E para është Help Guide (Udhëzuesi i ndihmës), në të cilin renditen mjetet, butonat dhe veçoritë e provimit që janë në dispozicion gjatë provimit. Mund ta shihni këtë informacion gjatë provimit duke klikuar ikonën e pikëpyetjes në cepin e djathtë të sipërm të ekranit tuaj. Pasi të jeni futur në provim dhe pasi të keni lexuar udhëzimet, navigoni nëpër provim dhe kaloni nga pyetja në pyetje duke përdorur shigjetat para dhe prapa në cepin e majtë të sipërm të ekranit. Gjatë provimit, do të keni mundësi të përdorni një orë. Mund ta shfaqni ose fshihni orën duke klikuar ikonën e orës në cepin e djathtë të sipërm të ekranit. Ora do të fillojë të numërojë mbrapsht kohën që ju ka mbetur në pjesë. Kur koha për atë pjesë të ketë mbaruar, do të nxirreni automatikisht jashtë testit. Ka ndonjë pyetje?

Pasi t'i keni dhënë përgjigje të gjitha pyetjeve, kontrollori do të thotë:

-  Kutia e dytë tregon rregullat dhe kushtet për këtë provim. Merrni disa minuta kohë për t'i lexuar këto rregulla dhe kushte. Ju pranoni të mos ndani asnjë pyetje specifike të provimit me asnjë, në asnjë lloj forme komunikimi duke përfshirë email, mesazhe tekst, postime në linjë ose përdorim tjetër interneti. Bërja e kësaj mund të shkaktojë anulim të rezultatit ose sanksionim tjetër të mundshëm. Kur të keni mbaruar leximin, klikoni kutinë **"I agree to the Terms and Conditions." ("Unë i pranoj rregullat dhe kushtet".)** Nga kjo faqe, mund të shikoni gjithashtu parametrat e provimit tuaj. Këto janë parametra dëgjimi, shikimi dhe përqendrimi të provimit që janë konfiguruar për t'ju ndihmuar juve, nëse jeni aprovuar për to. Konfirmoni që të gjitha informacionet në këtë faqe të jenë të sakta për provimin tuaj. Nëse ndonjë informacion nuk është i saktë, ngrini dorën. Nëse i gjithë informacioni është i saktë, shkoni në fund të faqes dhe klikoni **OK (Në rregull)**. Tani shtypni butonin **Start (Fillo)** në fund të ekranit. Duhet të zgjidhni kutinë e shënimit të rregullat dhe kushtet që butoni të jetë aktiv.

Pastaj kontrollori do të thotë:

-  Ju lutem mëni mënjanë biletën e provimit; do t'ju duhet të referoni numrin e regjistrimit tuaj për pjesën tjetër të provimit. Unë do të mbledh biletat pasi të ketë mbaruar provimi. Tani duhet të shihni një mesazh "Waiting for Approval" ("Duke pritur aprovimin"). Nëse nuk e shihni këtë mesazh, ngrini dorën.

Shikoni një foto ekrani të përkthyer të faqes "You Are Almost Ready to Begin" ("Jeni pothuajse gati për të filluar") me tre kuti informacioni më poshtë:

Jeni pothuajse gati për të filluar

Ju lutem shihni informacionin e mëposhtëm dhe klikoni "Start" ("Fillo") për të filluar.

Udhëzuesi i ndihmës

Udhëzuesi i ndihmës dhe rregullat e testit mund të hapen në çdo kohë duke përdorur butonin në pjesën e sipërme të faqes së provimit.

[Shikoni udhëzimet dhe Ndhimën](#)

Rregullat dhe kushtet

Duke shënuar kutinë më poshtë, ju pranoni se:

- Jeni personi me emrin e shkruar në biletën e provimit si pjesëmarrës i këtij provimi dixhital
- E kuptoni që të gjitha informacionet e paraqitura në këtë provim zotërohen vetëm nga bordi i kolegjit
- Nuk duhet të ndani asnjë pyetje specifike ose përgjigje të provimit me asnjë, në asnjë lloj forme komunikimi duke përfshirë emailin, mesazhe tekst, postime në internet ose përdorim tjetër interneti
- Nuk do të përdorni mjete ndihmëse të paautorizuara, si për shembull celularë dhe pajisje të ndaluara, gjatë provimit ose në pushime
- Do t'i përmbaheni të gjitha rregullave dhe kushteve të SAT, siç janë politikat për sigurinë dhe drejtësinë e provimit SAT të cilat ndodhen në udhëzuesin SAT për studentët dhe në këtë platformë
- E kuptoni që çdo shkelje e rregullave dhe kushteve mund të çojë në anulim të rezultatit, t'ju ndalojë të bëni provime të tjera në të ardhmen dhe, në varësi të natyrës së shkeljes, t'i raportohet agjencive të zbatimit të ligjit
- E kuptoni se nëse shkolla i jep bordit të kolegjit të dhëna rreth jush, bordi i kolegjit mund t'i ruajë ato të dhëna për të ofruar shërbime arsimore në lidhje me këtë provim të tilla si raportime dhe pranime e mundësi shkollimi

Unë i pranoj rregullat dhe kushtet

Parametrat e provimit

Përdorni këtë buton për të rishikuar parametrat e provimit.

[Shiko parametrat e provimit](#)

2.3 Pjesa 1: Test i leximit



Koha standarde për pjesën 1 është **65 minuta**, me një **pushim 10-minutësh** në fund të pjesës. Nëse po bëni provimin me një lehtësi të miratuar, koha dhe pushimet mund të jenë ndryshe. Ju lutem dëgjoni me kujdes lajmërimet që ju lexohen nga kontrollori. Një përkthim i udhëzimeve të pjesës të provimit shfaqet pas udhëzimeve të përkthyer me gojë.

Kur studentët të jenë gati, kontrollori do të thotë:



Ju lutem dëgjoni këto udhëzime për testin e leximit. Pasi të fillojmë, do të keni 65 minuta kohë për të punuar me pjesën 1, testin e leximit. Do të bëjmë një pushim të shkurtër kur të mbarojë kjo pjesë.

Mund të përdorni letrën e veçantë që ju jepet për të mbajtur shënime. Nëse ju duhen letra të tjera shënimesh gjatë provimit, ngrini dorën kur t'ju duhet dhe unë do t'ju jap.

Mos harroni se merrni pikë për përgjigjet e sakta por nuk humbisni pikë për përgjigjet e gabuara. Kjo do të thotë se duhet të përpiqeni t'i përgjigjeni çdo pyetjeje edhe nëse nuk jeni i sigurt për përgjigjen e saktë.

Nëse keni pyetje rreth procedurave të provimit, ju lutem bëjini tani. Nuk mund t'i përgjigjem pyetjeve që lidhen me përmbajtjen e provimit gjatë pjesëve me kohë të provimit. Ka ndonjë pyetje?

Koha e provimit do të fillojë pasi t'ju aprovoj unë dhe kur udhëzimet e provimit të jenë shfaqur në ekran. Kur të keni përfunduar provimin, ju lutem rrini ulur me qetësi dhe prisni udhëzime të mëtejshme. Mos e mbyllni laptopin ose mos e fikni pajisjen tuaj. Mos harroni, pasi të ketë mbaruar provimi, askush nuk mund të largohet nga dhoma derisa unë të njoftoj për leje për pushim ose për t'u larguar.

Pastaj kontrollori do të thotë:



Lexoni udhëzimet, më pas përdorni shigjetat e navigimit për të parë pyetjen e parë të testit dhe filloni punën.

Pasi të keni filluar provimin, kontrollori do të thotë:



Koha fillon tani. Suksese.

2.3.1 Pjesa 1 Udhëzimet e provimit



Më poshtë keni një përkthim të udhëzimeve që gjenden në fillim të pjesës 1 të shfletuesit të sigurt.


Testi i leximit SAT

52 Pyetje

UDHËZIME

Pas çdo fragmenti ose çifti fragmentesh ky test vazhdon me disa pyetje. Pasi të keni lexuar çdo fragment ose çift fragmentesh, zgjidhni përgjigjen më të mirë për t'iu përgjigjur pyetjes duke u bazuar në atë çka është thënë ose nënkuptuar në fragment dhe në çdo grafik të shoqëruar (si tabelë ose diagram). Për referencë, çdo paragrafi ka numër. Në disa raste, një ose më shumë pjesë të tekstit mund të theksohen për të tërhequr vëmendjen tuaj ndaj një pike ose ndaj disa pikave në tekst të cekura nga pyetja.

Kur ka 5 minuta të mbetura në këtë pjesë, do të shihni një mesazh që shfaqet poshtë ekranit. Mesazhi thotë: "Keni edhe 5 minuta të mbetura në këtë pjesë." Ky mesazh do të shfaqet në çdo pjesë.

You have 5 minutes remaining in this section 

Më poshtë është një përkthim i faqes së rishikimit që do të shfaqet pas çdo pjese të provimit. Figura më poshtë është një shembull se çfarë mund të shihni. Emri i testit të caktuar nuk është përfshirë në të.

Ju keni arritur në fund të kësaj pjese:

Ju lutem rishikoni përgjigjet tuaja para se të vazhdoni me provimin. **Nuk do të** jeni në gjendje t'i ktheheni këtyre pyetjeve më vonë.

Klikoni mbi një numër pyetjeje më poshtë për ta rishikuar.



Ju keni shënuar pyetjet. Rishikoni këto pyetje para se të paraqitni testin tuaj.




Ky simbol tregon artikujt pa përgjigje.

Pyetjet:


1	4 	7	10	13
2  	5	8 	11  	14  
3	6 	9	12 	15

Pasi të ketë mbaruar seanca e provimit, kontrollori do të thotë:

-  Testi i leximit tani ka përfunduar. Duhet të jeni në faqen e hyrjes në shfletuesin e sigurt. Nëse nuk e shihni këtë ekran, ngrini dorën.

Unë do të vij rrotull në sallë dhe do të mbledh fletët e shënimeve.

Pasi të jenë mbledhur fletët e shënimeve, kontrollori do të thotë:

-  Ju lutem mos dilni nga shfletuesi i sigurt. Tani do të bëjmë një pushim për 10 minuta. Nëse keni marrë me vete diçka për të ngrënë, mund ta hani vetëm në vendet e caktuara. Mos shkoni në asnjë vend tjetër përveçse në vendet e caktuara, në korridor ose në banjë. Nuk lejohet të keni ose përdorni telefon ose asnjë pajisje tjetër elektronike në këtë pushim ose në asnjë pushim tjetër gjatë provimit. Të gjithë telefonat dhe pajisjet e tjera duhet të mbeten të fikura dhe të lihen mënjanë derisa të mbarojë provimi. Mos flisni në korridor ose mos diskutoni pyetjet e provimit me asnjë. Tregoni konsideratë për ata që janë në dhomat e tjera. Do të fillojmë provimin përsëri pas saktësisht 10 minutash.

2.3.2 Gjatë pushimit

Në fund të pushimit, kontrollori do të thotë:

-  Ju lutem uluni.


Tani do t'ju jap letrat e shënimeve për pjesën tjetër të provimit.

2.4 Pjesa 2: Testi i shkrimit dhe gjuhës




*Koha standarde për pjesën 2 është **35 minuta**. Nëse po bëni provimin me një lehtësi të miratuar, koha dhe pushimet mund të jenë ndryshe. Ju lutem dëgjoni me kujdes lajmërimet që ju lexohen nga kontrollori. Një përkthim i udhëzimeve të pjesës të provimit shfaqet pas udhëzimeve të përkthyer me gojë.*


Kur të gjithë të jenë gati, kontrollori do të thotë:

-  Njëlloj siç bëtë me pjesën e mëparshme, vendosni Session ID (ID-në e seancës) që është në dërrasë dhe hyni në shfletuesin e sigurt.

Kur të gjithë të kenë hyrë, kontrollori do të thotë:


-  Kontrolloni që informacioni është i saktë në faqen "Is This You?" ("A jeni ju?"). Nëse është i saktë, klikoni **Yes (Po)**. Më pas duhet të shihni një mesazh "Waiting for Approval" ("Duke pritur aprovimin"). Ju lutem rriini ulur qetë dhe prisni aprovimin.

Kur të gjithë studentët të jenë pranuar, kontrollori do të thotë:

-  Tani duhet të shihni kutitë Help Guide (Udhëzuesi i ndihmës) dhe Test Settings (Parametrat e provimit). Mos harroni se mund t'i shihni informacionet rreth mjeteve e veçorive të provimit gjatë provimit duke klikuar ikonën e pikëpyetjes në cepin e djathtë të sipërm të ekranit.

Klikoni **Start (Fillo)**. Duhet të shihni një mesazh "Waiting for Approval" ("Duke pritur aprovimin"). Nëse nuk e shihni këtë mesazh, ngrini dorën.

Kur të gjithë të jenë gati, kontrollori do të thotë:


-  Para se të aprovoj të gjithë, ju lutem dëgjoni këto udhëzime për pjesën 2: Testi i shkrimit dhe gjuhës. Mund të përdorni letrën e veçantë që ju jepet për të mbajtur shënime. Nëse ju duhen letra të tjera shënimesh gjatë provimit, ngrini dorën kur t'ju duhet dhe unë do t'ju jap.

Disa pyetje në këtë pjesë kanë vetëm katër alternativa me përgjigje. Në këto raste, zgjidhni alternativën që mendoni se është alternativa më e mirë në kontekstin e fragmentit.

Nëse mbaroni para se të jetë lajmëruar fundi i kësaj pjese, keni mundësinë t'i rishikoni përgjigjet tuaja vetëm për këtë pjesë. Nëse e mbaroni rishikimin, ju lutem rrini ulur me qetësi dhe prisni udhëzime të mëtejshme.

Keni 35 minuta kohë për të punuar me testin e shkrimit dhe gjuhës.

Pastaj kontrollori do të thotë:

-  Pasi të aprovoj hyrjen tuaj në provim, do të shihni udhëzimet për provimin. Lexoni udhëzimet, më pas përdorni shigjetat e navigimit për të parë pyetjen e parë të testit dhe filloni punën.

Pasi të ketë filluar provimi, kontrollori do të thotë:

-  Koha fillon tani. Suksese.

2.4.1 Pjesa 2 Udhëzimet e provimit



Më poshtë keni një përkthim të udhëzimeve që gjenden në fillim të pjesës 2 të shfletuesit të sigurt.

Testi i shkrimit dhe gjuhës SAT

44 pyetje

UDHËZIME

Çdo fragment në test shoqërohet me disa pyetje. Për disa pyetje, do të mendoni si mund të ndryshohet fragmenti për të përmirësuar shprehjen e ideve. Për pyetje të tjera, do të mendoni si mund të redaktohet fragmenti për të korrigjuar gabimet në strukturën, përdorimin ose shenjat e pikësimit të fjalive. Një fragment ose një pyetje mund të shoqërohet me një ose

më shumë grafikë (si për shembull tabelë ose diagram) të cilat do t'i merrni parasysh ndërsa merrni vendime për ndërhyrje dhe redaktime.

Disa pyetje do t'ju drejtojnë te një pjesë e nënvizuar e një fragmenti. Disa pyetje të tjera do t'ju drejtojnë te një vend në fragment ose do t'ju kërkojnë të mendoheni për komplet fragmentin.

Pasi të keni lexuar çdo fragment, zgjidhni përgjigjen për t'iu përgjigjur pyetjes që përmirëson më së miri cilësinë e shkrimit në fragment ose që e bën fragmentin të përputhet me rregullat e gjuhës angleze të shkruar standarde. Shumë pyetje mund të kenë një opsion "ASNJË NDRYSHIM". Zgjidhni atë opsion nëse mendoni se zgjedhja më e mirë është ta lini siç është pjesën përkatëse të fragmentit.

Disa pyetje kanë **vetëm** katër alternativa përgjigjesh. Në këto raste, zgjidhni alternativën që mendoni se është alternativa më e mirë në kontekstin e fragmentit.

seekers an e-mail or text message when a relevant job has been posted. Knowing how to use these features and navigate the sites **5** make it much easier for job seekers to connect with employers.

5

(A) NO CHANGE

(B) makes


(C) are making

(D) have made

2.4.2 Gjatë provimit

Kontrollori do të shfaqë në dërrasë kohën e përafërt të fillimit dhe ndalimit.

Kur seanca e testimit të ketë mbaruar, kontrollori do të thotë:


-  Testi i shkrimit dhe gjuhës tani ka përfunduar. Duhet të jeni në faqen e hyrjes në shfletuesin e sigurt. Nëse nuk e shihni këtë ekran, ngrini dorën.

2.5 Pjesa 3: Testi i matematikës - Pa makinë llogaritëse




*Koha standarde për pjesën 3 është **25 minuta**, me një **pushim 5-minutësh** në fund të pjesës. Nëse po e bëni provimin me një mjet të miratuar, koha dhe pushimet mund të jenë ndryshe. Ju lutem dëgjoni me kujdes lajmërimet që ju lexohen nga kontrollori. Një përkthim i udhëzimeve të pjesës të provimit shfaqet pas udhëzimeve të përkthyer me gojë.*


Kur të gjithë të jenë gati, kontrollori do të thotë:

-  Njëlloj siç bëtë me pjesën e mëparshme, vendosni Session ID (ID-në e seancës) që është në dërrasë dhe hyni në shfletuesin e sigurt.

Kur të gjithë të kenë hyrë, kontrollori do të thotë:


-  Kontrolloni që informacioni është i saktë në faqen "Is This You?" ("A jeni ju?"). Nëse është i saktë, klikoni **Yes (Po)**. Më pas duhet të shihni një mesazh "Waiting for Approval" ("Duke pritur aprovimin"). Ju lutem rriini ulur qetë dhe prisni aprovimin.

Kur të gjithë studentët të jenë pranuar, kontrollori do të thotë:

-  Tani duhet të shihni kutitë Help Guide (Udhëzuesi i ndihmës) dhe Test Settings (Parametrat e provimit). Mos harroni se mund t'i shihni informacionet rreth mjeteve e veçorive të provimit gjatë provimit duke klikuar ikonën e pikëpyetjes në cepin e djathtë të sipërm të ekranit.

Klikoni **Start (Fillo)**. Duhet të shihni një mesazh "Waiting for Approval" ("Duke pritur aprovimin"). Nëse nuk e shihni këtë mesazh, ngrini dorën.

Kur të gjithë të jenë gati, kontrollori do të thotë:

-  Para se të aprovoj të gjithë për të filluar provimin, ju lutem dëgjoni këto udhëzime për pjesën 3: Testi i matematikës pa makinë llogaritëse.


Megjithëse kjo është një pjesë matematike, nuk ju lejohet të përdorni makinë llogaritëse në këtë pjesë të provimit, përveç nëse jeni aprovuar për të përdorur një makinë llogaritëse me katër funksione si mjet. Ju lutemi ta mbani makinën llogaritëse poshtë bankës. Për pyetjet që ju kërkojnë të vendosni përgjigjen në kuti, ndiqni udhëzimet e provimit për të vendosur përgjigjet tuaja. Për këto pyetje, mos filloni asnjë përgjigje me një zero.

Nëse ju duhen letra të tjera shënimesh gjatë provimit, ngrini dorën kur t'ju duhet dhe unë do t'ju jap.

Nëse mbaroni para se të jetë lajmëruar fundi i kësaj pjese, keni mundësinë t'i rishikoni përgjigjet tuaja vetëm për këtë pjesë. Nëse e mbaroni rishikimin, ju lutem rriini ulur me qetësi dhe prisni udhëzime të mëtejshme.

Keni 25 minuta kohë të punoni në testin e matematikës pa makinë llogaritëse.

Pastaj kontrollori do të thotë:

-  Pasi të aprovoj hyrjen tuaj në provim, do të shihni udhëzimet për provimin. Lexoni udhëzimet, më pas përdorni shigjetat e navigimit për të parë pyetjen e parë të testit dhe filloni punën.

Pasi të ketë filluar provimi, kontrollori do të thotë:

-  Koha fillon tani. Suksese.

2.5.1 Pjesa 3 Udhëzimet e provimit



Më poshtë keni një përkthim të udhëzimeve që gjenden në fillim të pjesës 3 të shfletuesit të sigurt.

Testi i matematikës SAT - Pa makinë llogaritëse

20 pyetje


UDHËZIME

Për pyetjet 1-15, zgjidhni çdo problem dhe zgjidhni përgjigjen më të mirë në alternativat e dhëna. **Për pyetjet 16-20**, zgjidhni problemin dhe vendosni përgjigjen tuaj në kutinë e përgjigjeve. Ju lutem shikoni udhëzimet para pyetjes 16 se si të vendosni përgjigjet tuaja. Mund të përdorni letër të veçantë për shënime.


SHËNIME

1. **Nuk lejohet** përdorimi i një makine llogaritëse.
2. Të gjitha ndryshoret dhe shprehjet e përdorura tregojnë numra realë përveç nëse tregohet ndryshe.
3. Figurat e dhëna në këtë provim janë vizatuar në raporte proporcionale përveç nëse tregohet ndryshe.
4. Të gjitha figurat janë vendosur në plan të rrafshët përveç nëse tregohet ndryshe.
5. Përveç nëse tregohet ndryshe, integrali i një funksioni të dhënë $f(x)$ është grupi i të gjithë numrave realë x për të cilët $f(x)$ është një numër real.


REFERENCË




$$A = \pi r^2$$
$$C = 2\pi r$$





$$A = \ell w$$




$$A = \frac{1}{2}bh$$




$$c^2 = a^2 + b^2$$




Trekëndësha kënddrejtë
të posaçëm




$$V = \ell wh$$




$$V = \pi r^2 h$$



$$V = \frac{4}{3}\pi r^3$$



$$V = \frac{1}{3}\pi r^2 h$$



$$V = \frac{1}{3}\ell wh$$

Numri i gradëve të harkut në një rreth është 360.

Numri i radianëve të harkut në një rreth është 2π .

Shuma e matjeve në gradë e këndeve të një trekëndëshi është 180.

Për pyetjet 16-20, zgjidhni problemin dhe vendosni përgjigjen tuaj në kuti siç tregohet më poshtë.

1. Vetëm numrat zero deri në infinit, presja dhjetore dhe vija e fraksionit (/) mund të vendosen në kutinë e përgjigjeve.
2. Asnjë pyetje nuk ka përgjigje negative.
3. Disa probleme mund të kenë më shumë se një përgjigje të saktë. Në këto raste, vendosni vetëm një përgjigje.
4. **Numrat e përzierë** të tillë si $3\frac{1}{2}$ duhet të vendosen si 3,5 ose 7/2. (Nëse vendoset $3\frac{1}{2}$ në kutinë e përgjigjes, ai do të interpretohet si $\frac{31}{2}$, jo si $3\frac{1}{2}$.)
5. **Përgjigjet dhjetore:** Kutia e përgjigjes lejon vendosjen e gjithsej 4 karaktereve. Nëse keni një përgjigje me numër dhjetor me më shumë se 4 karaktere, mund të rumbullakoset ose të pritët, por 4 karaktere duhet të vendosen në kuti.
6. **Zerot e fillimit:** Mos e filloni përgjigjen tuaj me një zero.
7. Disa shembuj janë:

Përgjigja	Mënyra ose mënyrat e pranueshme për vendosjen e përgjigjes	E papranueshme; NUK do të marrë pikë
$\frac{7}{12}$	7/12 .583	0.58
2.5	2.5 2.50 5/2	21/2
$\frac{2}{3}$	2/3 .666 .667	0.66 0.67


SHËNIME

1. **Nuk lejohet** përdorimi i një makine llogaritëse.
2. Të gjitha ndryshoret dhe shprehjet e përdorura tregojnë numra realë përveç nëse tregohet ndryshe.
3. Figurat e dhëna në këtë provim janë vizatuar në raporte proporcionale përveç nëse tregohet ndryshe.
4. Të gjitha figurat janë vendosur në plan të rrafshët përveç nëse tregohet ndryshe.
5. Përveç nëse tregohet ndryshe, integrali i një f të dhënë është grupi i të gjithë numrave realë x për të cilët $f(x)$ është një numër real.


2.5.2 Gjatë provimit

Kontrollori do të shfaqë në dërrasë kohën e përafërt të fillimit dhe ndalimit.

Kur seanca e testimit të ketë mbaruar, kontrollori do të thotë:

-  Testi i matematikës pa makinë llogaritëse tani ka përfunduar. Duhet të jeni në faqen e hyrjes në shfletuesin e sigurt. Nëse nuk e shihni këtë ekran, ngrini dorën.
Do të mbledh letrat e shënimeve tuaja.

Pasi të jenë mbledhur fletët e shënimeve, kontrollori do të thotë:

-  Ju lutem mos dilni nga shfletuesi i sigurt. Tani do të bëjmë një pushim për 5 minuta. Nëse keni marrë me vete diçka për të ngrënë, mund ta hani vetëm në vendet e caktuara. Mos shkoni në asnjë vend tjetër përveçse në vendet e caktuara, në korridor ose në banjë. Nuk lejohet të keni ose përdorni telefon ose asnjë pajisje tjetër elektronike në këtë pushim ose në asnjë pushim tjetër gjatë provimit. Të gjithë telefonat dhe pajisjet e tjera duhet të mbeten të fikura dhe të lihen mënjanë derisa të mbarojë provimi. Mos flisni në korridor ose mos diskutoni pyetjet e provimit me asnjë. Tregoni konsideratë për ata që janë në dhomat e tjera. Do të fillojmë provimin përsëri pas saktësisht 5 minutash.

2.5.3 Gjatë pushimit

Në fund të pushimit, kontrollori do të thotë:


-  Ju lutem uluni.
Tani do t'ju jap letrat e shënimeve për pjesën tjetër të provimit.

2.6 Pjesa 4: Testi i matematikës - Makina llogaritëse




*Koha standarde për pjesën 4 është **55 minuta**. Nëse po bëni provimin me një lehtësi të miratuar, koha dhe pushimet mund të jenë ndryshe. Ju lutem dëgjoni me kujdes lajmërimet që ju lexohen nga kontrollori. Një përkthim i udhëzimeve të pjesës të provimit shfaqet pas udhëzimeve të përkthyer me gojë.*

Kur të gjithë të jenë gati, kontrollori do të thotë:

-  Njëlloj siç bëtë me pjesën e mëparshme, vendosni Session ID (ID-në e seancës) që është në dërrasë dhe hyni në shfletuesin e sigurt.

Kur të gjithë të kenë hyrë, kontrollori do të thotë:

-  Kontrolloni që informacioni të jetë i saktë në faqen "Is This You?" ("A jeni ju?"). Nëse është i saktë, klikoni **Yes (Po)**. Më pas duhet të shihni një mesazh "Waiting for Approval" ("Duke pritur aprovimin"). Ju lutem rriini ulur qetë dhe prisni aprovimin.

Kur të gjithë studentët të jenë pranuar, kontrollori do të thotë:

- Tani duhet të shihni kutitë Help Guide (Udhëzuesi i ndihmës) dhe Test Settings (Parametrat e provimit). Mos harroni se mund t'i shihni informacionet rreth mjeteve e veçorive të provimit gjatë provimit duke klikuar ikonën e pikëpyetjes në cepin e djathtë të sipërm të ekranit.

Klikoni **Start (Fillo)**. Duhet të shihni një mesazh "Waiting for Approval" ("Duke pritur aprovimin"). Nëse nuk e shihni këtë mesazh, ngrini dorën.

Kur të gjithë të jenë gati, kontrollori do të thotë:

- Para se të aprovoj të gjithë për të filluar provimin, ju lutem dëgjoni këto udhëzime për pjesën 4: Testi i matematikës me makinë llogaritëse. Për këtë pjesë, mund të përdorni një makinë llogaritëse. Nëse keni marrë me vete makinë llogaritëse, ju lutem nxirreni dhe vendoseni mbi bankë. Gjithashtu mund të përdorni makinën llogaritëse me grafik për këtë pjesë. Klikoni ikonën e makinës llogaritëse në shiritin e mjeteve për ta përdorur këtë mjet gjatë provimit.

Kur të përdorni makinën llogaritëse, ndiqni këto udhëzime:

- Mbajeni mbi bankë ose mbajeni në mënyrë të tillë që studentët e tjerë të mos shohin dot punën tuaj.
- Mos e ndani ose mos e shkëmbeni makinën llogaritëse.
- Nëse keni marrë me vete makinë llogaritëse rezervë, mbajeni poshtë bankës.
- Nëse makina juaj llogaritëse priset dhe keni bateri ose makinë llogaritëse rezervë, ngrini dorën. Do të shikoj nëse mjeti juaj zëvendës është i pranueshëm. Nëse nuk keni rezervë, vazhdoni me provimin. Mos harroni, mund të përdorni edhe makinën llogaritëse në ekran. Të gjitha pyetjeve të matematikës mund t'u jepet përgjigje edhe pa makinë llogaritëse.

Mund të përdorni letrën e veçantë që ju jepet për të mbajtur shënime. Nëse ju duhen letra të tjera shënimesh gjatë provimit, ngrini dorën kur t'ju duhet dhe unë do t'ju jap.

Për pyetjet që ju kërkojnë të vendosni përgjigjen në kuti, ndiqni udhëzimet e provimit për të vendosur përgjigjet tuaja. Për këto pyetje, mos filloni asnjë përgjigje me një zero.

Nëse mbaroni para se të jetë lajmëruar fundi i kësaj pjese, keni mundësinë t'i rishikoni përgjigjet tuaja vetëm për këtë pjesë. Pasi të mbaroni rishikimin, ju lutem rrini ulur me qetësi dhe prisni udhëzime të mëtejshme.

Ka ndonjë pyetje?

Keni 55 minuta kohë të punoni në testin e matematikës me makinë llogaritëse.

Pastaj kontrollori do të thotë:

- Pasi të aprovoj hyrjen tuaj në provim, do të shihni udhëzimet për provimin. Lexoni udhëzimet, më pas përdorni shigjetat e navigimit për të parë pyetjen e parë të testit dhe filloni punën.

Pasi të ketë filluar provimi, kontrollori do të thotë:

- Koha fillon tani. Suksese.

2.6.1 Pjesa 4 Udhëzimet e provimit



Më poshtë keni një përkthim të udhëzimeve që gjenden në fillim të pjesës 4 të shfletuesit të sigurt.

Testi i matematikës SAT - Makina llogaritëse

38 Pyetje


UDHËZIME

Për pyetjet 1-30, zgjidhni çdo problem dhe zgjidhni përgjigjen më të mirë në alternativat e dhëna. **Për pyetjet 31-38**, zgjidhni problemin dhe vendosni përgjigjen tuaj në kutinë e përgjigjeve. Ju lutem shikoni udhëzimet para pyetjes 31 se si të vendosni përgjigjet tuaja. Mund të përdorni letër të veçantë për shënime.


SHËNIME

1. **Lejohet** përdorimi i makinës llogaritëse.
2. Të gjitha ndryshoret dhe shprehjet e përdorura tregojnë numra realë përveç nëse tregohet ndryshe.
3. Figurat e dhëna në këtë provim janë vizatuar në raporte proporcionale përveç nëse tregohet ndryshe.
4. Të gjitha figurat janë vendosur në plan të rrafshët përveç nëse tregohet ndryshe.
5. Përveç nëse tregohet ndryshe, integrali i një funksioni të dhënë f është grupi i të gjithë numrave realë x për të cilët $f(x)$ është një numër real.


REFERENCË




$$A = \pi r^2$$
$$C = 2\pi r$$




$$A = \ell w$$




$$A = \frac{1}{2}bh$$




$$c^2 = a^2 + b^2$$



Trekëndësha kënddrejtë
të posaçëm




$$V = \ell wh$$




$$V = \pi r^2 h$$



$$V = \frac{4}{3}\pi r^3$$



$$V = \frac{1}{3}\pi r^2 h$$



$$V = \frac{1}{3}\ell wh$$

Numri i gradëve të harkut në një rreth është 360.

Numri i radianëve të harkut në një rreth është 2π .

Shuma e matjeve në gradë e këndeve të një trekëndëshi është 180.

Për pyetjet 31 - 38, zgjidhni problemin dhe vendosni përgjigjen tuaj në kuti siç tregohet më poshtë.

1. Vetëm numrat zero deri në infinit, presja dhjetore dhe vija e fraksionit (/) mund të vendosen në kutinë e përgjigjeve.
2. Asnjë pyetje nuk ka përgjigje negative.
3. Disa probleme mund të kenë më shumë se një përgjigje të saktë. Në këto raste, vendosni vetëm një përgjigje.
4. **Numrat e përzierë** të tillë si $3\frac{1}{2}$ duhet të vendosen si 3,5 ose $7/2$. (Nëse vendoset $3\frac{1}{2}$ në kutinë e përgjigjes, ai do të interpretohet si $\frac{31}{2}$, jo si $3\frac{1}{2}$.)
5. **Përgjigjet dhjetore:** Kutia e përgjigjes lejon vendosjen e gjithsej 4 karaktereve. Nëse keni një përgjigje me numër dhjetor me më shumë se 4 karaktere, mund të rumbullakoset ose të pritët, por 4 karaktere duhet të vendosen në kuti.
6. **Zerot e fillimit:** Mos e filloni përgjigjen tuaj me një zero.

Disa shembuj janë:


Përgjigja	Mënyra ose mënyrat e pranueshme për vendosjen e përgjigjes	E papranueshme; NUK do të marrë pikë
$\frac{7}{12}$	7/12 .583	0.58
2.5	2.5 2.50 5/2	21/2
$\frac{2}{3}$	2/3 .666 .667	0.66 0.67

SHËNIME

1. **Lejohet** përdorimi i makinës llogaritëse.
2. Të gjitha ndryshoret dhe shprehjet e përdorura tregojnë numra realë përveç nëse tregohet ndryshe.
3. Figurat e dhëna në këtë provim janë vizatuar në raporte proporcionale përveç nëse tregohet ndryshe.
4. Të gjitha figurat janë vendosur në plan të rrafshët përveç nëse tregohet ndryshe.
5. Përveç nëse tregohet ndryshe, integrali i një f të dhënë është grupi i të gjithë numrave realë x për të cilët $f(x)$ është një numër real.

2.6.2 Gjatë provimit


Kur seanca e testimit të ketë mbaruar, kontrollori do të thotë:

-  Testi i matematikës me makinë llogaritëse tani ka përfunduar. Duhet të jeni në faqen e hyrjes në shfletuesin e sigurt. Nëse nuk e shihni këtë ekran, ngrini dorën.

Do të mbledh letrat e shënimeve tuaja.

Nëse po bëni SAT (pa ese), provimi ka përfunduar dhe kontrollori do të vazhdojë me pjesën: Pas provimit. Nëse po bëni SAT me ese, vazhdoni të lexoni udhëzimet që vijojnë.

Pasi të jenë mbledhur fletët e shënimeve, kontrollori do të thotë:

-  Ju lutem mos dilni nga shfletuesi i sigurt. Vendoseni makinën llogaritëse poshtë bankës. Tani do të keni disa minuta për t'u çlodhur. Mos i diskutoni pyetjet e provimit gjatë pushimit ose mos u largoni nga dhoma e provimit pa leje.

Do të fillojmë provimin përsëri pas 2 minutash.

2.6.3 Gjatë pushimit

Në fund të pushimit, kontrollori do të thotë:

-  Ju lutem uluni.


Tani do t'ju jap letrat e shënimeve për pjesën tjetër të provimit.

2.7 Eseja SAT




*Koha standarde për pjesën Eseja SAT është **50 minuta**. Nëse po bëni provimin me një lehtësi të miratuar, koha dhe pushimet mund të jenë ndryshe. Ju lutem dëgjoni me kujdes lajmërimet që ju lexohen nga kontrollori. Një përkthim i udhëzimeve për esenë shfaqet pas udhëzimeve të përkthyer me gojë.*


Kur të gjithë të jenë gati, kontrollori do të thotë:

-  Njëlloj siç bëtë me pjesën e mëparshme, vendosni Session ID (ID-në e seancës) që është në dërrasë dhe hyni në shfletuesin e sigurt.

Kur të gjithë të kenë hyrë, kontrollori do të thotë:

-  Kontrolloni që informacioni të jetë i saktë në faqen "Is This You?" ("A jeni ju?"). Nëse është i saktë, klikoni **Yes (Po)**. Më pas duhet të shihni një mesazh "Waiting for Approval" ("Duke pritur aprovimin"). Ju lutem rrini ulur qetë dhe prisni aprovimin.

Pasi të jenë pranuar studentët, kontrollori do të thotë:

-  Tani duhet të shihni kutitë Help Guide (Udhëzuesi i ndihmës) dhe Test Settings (Parametrat e provimit). Ka një kuti shtesë me një deklaratë për përdorimin e esesë. Merrni një moment për të lexuar deklaratën dhe më pas zgjidhni mes përgjigjeve të renditura. Kur të keni mbaruar së lexuari, ju lutem ngrini kokën.

Klikoni **Start (Fillo)**. Duhet të shihni një mesazh "Waiting for Approval" ("Duke pritur aprovimin"). Nëse nuk e shihni këtë mesazh, ngrini dorën.

Shikoni përkthimin e deklaratës së Nxjerrjes së esesë më poshtë:


Nxjerrja e esesë

Ju lutem merrni një moment për të lexuar deklaratën më poshtë.

E kuptoj se eseja ime (pa emrin tim) mund të riprodhohet në materiale të tjera të bordit të kolegjit për qëllime studimi. Nëse nuk jap lejen për të riprodhuar esenë time për qëllime që janë përtej raportimit të rezultatit dhe vlerësimit të aftësive të mia në shkrim, kjo nuk do të ketë asnjë ndikim në rezultatin tim, as nuk do të pengojë që eseja ime të vihet në dispozicion në ndonjë kolegji të cilit i dërgoj rezultatet e mia SAT.

- Po, jap lejen time.
- Jo, nuk e jap lejen time.

Kur të gjithë të jenë gati, kontrollori do të thotë:

-  Para se të aprovoj të gjithë për të filluar provimin, ju lutem dëgjoni këto udhëzime për pjesën 5: Eseja SAT.

Mund të përdorni letrën e veçantë për të bërë shënime dhe për të planifikuar esenë tuaj, por çdo gjë që shkruhet nuk do të llogaritet për rezultatin. Nëse ju duhen letra të tjera shënimesh gjatë provimit, ngrini dorën kur t'ju duhet dhe unë do t'ju jap. Kur të jeni gati, filloni të shkruani esenë tuaj në dritaren e dokumentit në shfletuesin e sigurt të bordit të kolegjit.


Mos harroni se ora është në dispozicion gjatë testit për të monitoruar ecurinë tuaj.

Nëse mbaroni para se të jetë lajmëruar fundi i kësaj pjese, keni mundësinë të rishikoni punën tuaj vetëm për këtë pjesë. Nëse e mbaroni rishikimin, ju lutem rri ulur me qetësi dhe prisni udhëzime të mëtejshme.

Ka ndonjë pyetje?

Keni 50 minuta kohë të punoni me esenë SAT.

Pastaj kontrollori do të thotë:

-  Pasi të aprovoj hyrjen tuaj në provim, do të shihni udhëzimet për provimin. Lexoni udhëzimet, më pas përdorni shigjetat e navigimit për të parë kërkesën e esesë dhe filloni punën.

Pasi të ketë filluar provimi, kontrollori do të thotë:

-  Koha fillon tani. Suksese.

2.7.1 Udhëzimet për testin e esesë SAT



Më poshtë është një përkthim i udhëzimeve që gjenden te shfletuesi i sigurt.

Eseja SAT

UDHËZIME


Eseja ju jep mundësinë të tregoni sa mirë mund të lexoni dhe kuptoni një fragment dhe të shkruani një ese duke analizuar fragmentin. Në esenë tuaj, duhet të tregoni se e keni lexuar fragmentin me kujdes, të bëni një analizë të qartë dhe logjike dhe të përdorni gjuhën me saktësi.

Lexoni fragmentin dhe në hapësirën e dhënë, shkruani një ese në përgjigje të kërkesës së dhënë. Nuk do të vlerësohen esetë që janë jashtë teme.

2.7.2 Gjatë provimit


Kontrollori do të shfaqë në dërrasë kohën e përafërt të fillimit dhe ndalimit.

Kur seanca e testimit të ketë mbaruar, kontrollori do të thotë:

-  Eseja SAT tani ka përfunduar. Duhet të jeni në faqen e hyrjes në shfletuesin e sigurt. Nëse nuk e shihni këtë ekran, ngrini dorën.
Do të mbledh letrat e shënimeve tuaja.

3 Pas provimit

Për të gjithë studentët, kontrollori do të thotë:


 Urime, sapo mbaruat provimin!

Tani, ju lutem dëgjoni këtë informacion të rëndësishëm. Nëse doni të anuloni rezultatet tuaja, duhet të njoftoni College Board me shkrim jo më vonë se 11:59 të darkës me orën lindore në ditën e katërt të javës duke filluar nga sot.


Nëse i anuloni rezultatet tuaja, ato përsëri do t'i dërgohen shtetit dhe rrethit, si edhe do të jenë në dispozicion për shkollën tuaj, por nuk do t'u dërgohen kolegjeve ose organizatave shkollore që keni zgjedhur ose nuk do të jenë në dispozicion në sistemin e raportimit të College Board.

3.1 Para se të largohen studentët


Për të gjithë studentët, kontrollori do të thotë:

 Tani do të mbledh biletat tuaja të provimit. Ju lutem rrini ulur me qetësi derisa t'ju lë të lirë.


Pasi të jenë marrë të gjitha materialet, kontrollori do të thotë:

 Do t'ju lë të lirë shumë shpejt. Mos harroni: Në asnjë rrethanë, nuk duhet të merrni me vete pyetjet e provimit jashtë dhomës së provimit ose t'i diskutoni me asnjë tjetër dhe me asnjë lloj forme, përfshirë me postën elektronike, mesazhet ose internetin.


Studentëve që kanë bërë provimin SAT me ese, kontrollori do të thotë:

 Përveç kësaj, nuk ju lejohet të diskutoni ose të ndani kërkesën e esesë së sotme derisa eseja të jetë e disponueshme online.

Nëse studentët duhet të mbledhin sendet e tyre, kontrollori do të thotë:

 Ky administrim provimi tani ka mbaruar. Ndërsa përgatiteni për t'u larguar, ju lutem afroheni dhe merrni sendet personale që ju mora më parë. Pasi të keni marrë të gjitha sendet tuaja, mund të dilni nga dhoma me qetësi. Ju lutem, kini parasysh se studentët në dhomat e tjera mund të jenë ende duke bërë provim. Urime përsëri dhe faleminderit për pjesëmarrjen dhe për gjithë punën tuaj të vështirë.

Nëse studentët i kanë marrë të gjitha sendet e tyre, kontrollori do të thotë:

 Ky administrim provimi tani ka mbaruar. Merrni sendet tuaja dhe dilni nga dhoma me qetësi. Ju lutem, kini parasysh se studentët në dhomat e tjera mund të jenë ende duke bërë provim. Urime përsëri dhe faleminderit për pjesëmarrjen dhe për gjithë punën tuaj të vështirë.